



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:070352

Datë: 21.09.2020

Numri i dokumentit: 01125888

**P.nr. 1045/18**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGGJITHSHËM**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve, B.M. për shkak të veprës penale te sulmit nga neni 184 par. 1 te KPRK-së dhe te pandehurit E.M. për shkak të veprës penale te sulmit nga neni 184 par. 1 te KPRK-së dhe veprës përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 375 par. 1 te KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr. 2644/18, të dt. 24.12.2018, pas mbajtjes së seancës publike te shqyrtimit gjyqësor, të dt. 09.09.2020, në prezencë të Prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari, të pandehurve B.M., E.M. dhe te dëmtuarit M.H., në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.21.09.2020, përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **Të pandehurit**

**B. M., i biri i I. dhe nënës GJ., e gjinisë D., i lindur me dt. ..., në Pejë, ku edhe jeton ne rr. "...", nr. 65, identifikohet në bazë të lnj.nr. personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion- automekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, i pamartuar, me nr. tel. ...., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.**

**E.M., i biri i I. dhe nënës E., e gjinisë X., i lindur me dt. ..., në Pejë, ku edhe banon në rr. "...", nr. 65 identifikohet në bazë të lnj.nr. personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion-automekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, i pamartuar, me nr. tel...., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.**

#### **1.PJESA REFUZUESE**

**Ndaj të pandehurit E. M.**

**Konform nenit 363 par. 1 nen par. 1.1 te KPP-së,**

**REFUZOHET - Aktakuza**

**Gjëja se:**

**I pandehuri E. M.**

- Me dt. 25.11.2018, rreth orëve te ditës ne Pejë, në rr.”...”, pikërisht afër shtëpisë se te dëmtuarit M.H., përdor në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm të armëve përdor armën në atë mënyrë që pasi i pandehuri e pret të dëmtuarin jashtë fushës së futbollit si në dispozitiv të dytë të aktakuze e pasi që i dëmtuari nuk del i pandehur me veturën e tij SEAT, me targa të Shqipërisë shkon afër shtëpisë së të dëmtuarit, nxjerr armën me të cilën shtien në ajër, ku më pas policia në vend të ngjarjes, gjen një gëzhjojë të kalibrit 9X19mm,

- Me çka kishte për të kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 375 par. 1 te KPRK-së.

Për shkak të heqjes dorë të prokurorit të shtetit nga aktakuza.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Pala e dëmtuar, M.H. me vendbanim në Pejë rr.....”, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

**2.PJESA DËNUESE**

**Të pandehurit B. M. DHE E. M.**

**JANË FAJTORË**

**Sepse,**

**I pandehuri B. M.**

- Me dt. 25.11.2018, rreth orëve te ditës ne Pejë, në fushën e futbollit “A...” me dashje përdor forcën ndaj te dëmtuarit M.H., ne atë mënyrë qe përderisa i dëmtuari dhe i pandehuri ndodheshin ne vendin e lartcekur dhe te njëjtit po luanin futboll, aty fillimisht fillon fjalosja ne mes tyre, ku me pas i pandehuri e sulmon te dëmtuarin duke e goditur me grushta , aty ndërhyjnë disa persona te cilët e largojnë te dëmtuarin , i pandehuri del nga fusha e futbollit dhe e pret të dëmtuarin, por i dëmtuari nga frika nuk del dhe strehohet ne lokalet e stadiumit te lartcekur,

- Me çka ka kryer veprën penale te sulmit nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

## **I pandehuri E.M.**

- Me dt. 25.11.2018, rreth orëve te ditës ne Pejë, në fushën e futbollit “A...” me dashje përdor forcën ndaj te dëmtuarit M.H., ne atë mënyrë qe përderisa i pandehuri B. e godet te dëmtuarin nga pas te dëmtuarit i shkon i pandehuri i cili e godet me grusht ne kokë te dëmtuarin, e me pas shkon ne veturën e tij, merr një çelës te gomave, me te cilën tenton ta godet te dëmtuarin , por ndërhyjnë disa person atë cilët edhe i ndajnë, me pas i pandehuri del nga fusha e futbollit dhe e pret te dëmtuarin të dal , por i dëmtuari nga frika nuk del dhe strehohet ne lokalet e stadiumit te lartcekur,

- Me çka ka kryer veprën penale te sulmit nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 38,39,40,43,69, 70, 71, 184 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit i:

## **G J Y K O N**

### **Të pandehurin B.M.**

- Dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, e të cilin dënim do te paguaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi ne afatin kohor brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve.

- Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

### **Të pandehurin B.M.**

- Dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, e të cilin dënim do te paguaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi ne afatin kohor brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve.

- Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

- Të pandehurit obligohen që secili veç e veç te paguajnë paushallin gjyqësor shumen prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Të pandehurit obligohen që secili veç e veç te paguajnë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- I dëmtuari M.H. nga Pejë, rr.”...”, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.2644/18, të dt. 24.12.2018, ndaj të pandehurve, B.M. për shkak të veprës penale te sulmit nga neni 187 par. 1 te KPRK-së dhe te pandehurit E.M. për shkak të veprës penale te sulmit nga neni 187 par. 1 te KPRK-së dhe te veprës përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 375 par. 1 te KPRK-së.

Ne seancën fillestare te mbajtur me date 16.09.2019, prokurori i shtetit para leximit të aktakuzës e bën rikualifikimin e veprës penale të sulmit, për të dy të pandehurit B.M. dhe E.M., ku secili veç e veç kanë kryer veprën penale të sulmit dhe në vend me çka kryer veprën penale të sulmit nga neni 187 par.1, të KPRK, duhet të jetë me çka ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1, të KPRK-së, dhe kjo meqenëse me hyrje në fuqi të kodit të ri penal dënimi i paraparë për këtë veprë penale sipas nenit 184 par.1, është më i favorshëm për të pandehurit. Ndërsa si i përket dispozitivit të tretë kundër të pandehurit E.M., ku në rreshtin e dytë dhe të tretë shkruan me qëllim të frikësimit me përdorimin e armës seriozisht e kanos të dëmtuarin, duhet të jetë: përdor në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm të armëve përdor armën në atë mënyrë që pasi i pandehuri e pret të dëmtuarin jashtë fushës së futbollit si në dispozitiv të dytë të aktakuzës e pasi që i dëmtuari nuk del i pandehur me veturën e tij SEAT, me targa të Shqipërisë shkon afër shtëpisë së të dëmtuarit, nxjerr armën me të cilën shtien në ajër, ku më pas policia në vend të ngjarjes, gjen një gëzhjë të kalibrit 9X19mm. Me çka ka kryer veprën penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1, të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i pandehuri E. M. ne seancën fillestare te mbajtur me dt. 16.09.2020 e ka pranuar fajësinë për veprën penale te sulmit nga neni 184 par. 1 te KPRK-së, ndërsa nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par 1 të KPRK-së. I pandehuri B.M. në sencen fillestar të dt. 16.09.2019 nuk e ka pranuar fajesin për veprën penal te sulmit nga neni 184 par1 të KPRK-së.

Me dt.09.09.2020, është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor ku prezent ishte Prokurori i Shteti Muharrem Bajraktari, i dëmtuari M.H. dhe te pandehurit B.M. dhe E.M.. Për arsye se nga shqyrtimi i fundit gjyqësor kishin kaluar me shumë se 3 muaj gjykata konform nenit 311 par 3 të KPP-së shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale ka filluar rishtazi.

Gjykata konform dispozitave te nenit 323, të KPP-së, i ka udhëzuar të pandehurit me të drejtat e tyre, ku në këtë rast të pandehurit deklarojnë se i kanë kuptuar këto të drejta dhe se për mbrojtës nuk kanë nevojë.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë të pandehurve qe të deklarohen

për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimi të fajësisë.

I pandehuri B. e ka pranuar fajësinë për veprën penale të sulmit nga neni 184 par 1 të KPP-së, ka shprehur pendimin për veprën e kryer dhe ka shtuar se me të dëmtuarin është pajtuar, kanë raporte të mira, premtan se më nuk do të përsëris vepra të tilla.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë M.in nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit ka deklaruar se: duke marr parasysh se i pandehuri në një formë edhe në deklaratën në polici e ka pranuar veprën e sulmit, po ashtu këtë e ka bërë edhe në prokurori si dhe edhe sot i njëjti përfundimisht e pranon fajësinë, andaj pranimi është në pajtim me provat dhe shkresat e lëndës bashkangjitur aktakuzës andaj nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit B. M..

I dëmtuari M.H., ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit B.M., nuk paraqet kërkesë pasurore juridike, meqenëse kanë raporte të mira familjare.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit B. dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 326 lidhur me nenin 248 të KPPK-së, atëherë ka marrë aktvendim dhe ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit B.

Meqenëse i pandehuri E. nuk e pranoj fajësinë për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par 1 të KPRK-së, shqyrtimi gjyqësorë ka vazhduar ndaj të pandehurit E.M. me administrimin e provave sa i përket veprës penale përdorimi ia armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par 1 të KPRK-së.

Pas dëgjimit të te dëmtuar M. H., dëshmitares G. H. dhe P. I., në seancën e shqyrtimit gjyqësor Prokurori i Shteti deklaroj se meqenëse këtu të pandehurit në shqyrtimet e mëhershme kanë pranuar veprat penale si në dispozitivin e parë dhe të dytë të aktakuzës dhe atë i pandehuri B. M., veprën nga dispozitivi i parë, ndërsa i pandehuri E., veprën nga dispozitivi i dytë, kërkoj nga gjykata që të njëjtit të shpallen fajtor secili për veprën penale që iu vihet në barrë sipas aktakuzës dhe të dënohen sipas ligjit. Sa i përket dispozitivit të tretë të aktakuzës, e cila i vihet në barrë të pandehurit E. dhe atë për vepër penale nga neni 375 par.1, të KPRK-së, për të njëjtën vepër dhe dispozitiv në mungesë të provave tërhiqem nga ndjekja penale ndaj të pandehurit E. si në dispozitivin e tretë të aktakuzës. Meqenëse nuk ka prova konkrete se i pandehuri E. e ka kryer veprën penale si në dispozitivin e tretë të aktakuzës, në prezencën e këtyre rrethanave tërhiqem nga ndjekja penale nga dispozitivi i tretë i aktakuzës, ndaj të pandehurit E.M., për shkak të veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 par.1, të KPRK-së.

Prokurori Muharrem Bajraktari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga vet pranimi i fajësisë që kanë bërë te pandehurit për veprat penale te sulmit nga neni 184 par 1 te KPRK-së, secilit që i vihet në barrë, u vërtetua se të njëjtit i kanë kryer veprat për të cilat e kanë pranuar fajësinë. Kërkon nga gjykata që të njëjtit ti shpall fajtorë për veprat penale që i kanë pranuar dhe ti dënojë sipas ligjit. Sa i përket veprës së tretë si në dispozitivin e aktakuzës që i vihet në barrë të

pandehurit E., për të njëjtin tërhiqet nga ndjekja penale për arsyet e cekura më lartë-në mungesë të provave.

I dëmtuari M.H., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrah fjalën e prokurorit nuk kërkon dëmshpërblim sepse me të pandehurit janë pajtuar dhe janë shokë të ngushtë.

I pandehuri B. M., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i vie keq për rastin që ka ndodhur, është shumë i penduar, me të dëmtuarin janë pajtuar dhe janë shokë dhe tani kanë raporte shumë të mira, kërkon nga gjykata që pranimin e fajësisë ti llogaritet si rrethanë lehtësuese.

I pandehuri E. M., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i vie keq për rastin që ka ndodhur, është shumë i penduar, me të dëmtuarin janë pajtuar dhe janë shokë dhe tani kanë raporte shumë të mira, kërkon nga gjykata që pranimin e fajësisë ti llogaritet si rrethanë lehtësuese.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, dhe pranimi i fajit mbështetet edhe në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit ... i datës 25.11.2018, raporti i policit R. M. i dt. 27.11.2018, raporti i policit B. GJ. dt. 25.11.2018, raporti i policeve hetues dt. 25.11.2018, deklarata e dëmtuarit M.H. e dhënë ne polici me dt. 26.11.2018, deklarata e te pandehurit B.M. dhënë ne polici me dt. 26.11.2018, deklarata e te pandehurit E.M. e dhënë ne polici me dt. 27.11.2018, deklarata e të dëmtuarit M. dt. 19.12.2018, deklarata e te pandehurit B. e dhënë në prokurori me dt. 19.12.2018, deklarata e te pandehurit E. e dhënë në prokurori me dt. 19.12.2018, si dhe shkresat tjera te lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 326 lidhur me nenin 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit B.M. dhe E.M. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale se ka kryer veprë penale te sulmit nga neni 184 par. 1 te KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin secilin veç e veç, gjykata mori pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, faktin se i dëmtuari deklaroj se janë pajtuar dhe tani kanë raportet të mira dhe janë shok, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, si dhe faktin se te pandehurit me parë nuk kanë qenë të dënuar dhe ndaj tyre nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurve gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.6 të KPPRK-se, për të pandehurit gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale, për paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenet 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të pandehurit i obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenet 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin i udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenet 363 par 1 nën par 1.1 dhe 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenet 370 të KPP-së, Gjykata përpiloi këtë aktgjykim. .

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,  
P.nr.1045/18, dt. 21.09.2020**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**GJYQTARI**

\_\_\_\_\_  
Selvane Bukleta

\_\_\_\_\_  
Shaqë Curri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.